



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 22, datë 06 / 03 / 2020

**MBI NJË NDRYSHIM AFATI TË VSA NR. 21, DATË 26.02.2020
MBI “NDRYSHIMIN E AFATIT TË KRYERJES SË PRAKTIKËS MËSIMORE PËR
CIKLIN E DYTË TË STUDIMEVE ME KOHË TË PLOTË MASTER I ARTEVE,
MASTER SHKENCOR DHE MASTER PROFESIONAL PËR TË GJITHA
PROGRAMET E STUDIMIT TË OFRUARA NGA FAKULTETET, NË
UNIVERSITETIN E ARTEVE SI DHE TË MIRATIMIT PARAPRAK TË PAGESËS
SË SIGURACIONIT PËR STUDENTËT E CIKLIT TË DYTË”**

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, në mbështetje të ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, të përcaktimeve të germës f, pika 1, ndarja I e VKM-së nr. 77, datë 28.01.2015, shkresës së dërguar nga ZVA Tiranë shkresa me nr. 1207 prot, datë 12.02.2020, “Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor, në lidhje me zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve” pasi rishikoi afatet e kryerjes së praktikës profesionale, me votim të hapur, unanimisht,

V E N D O S I:

1. Datat e zhvillimit të praktikës mësimore për të gjitha programet e ofruara për vitin e parë dhe vitin e dytë, në ciklin e dytë të studimeve me kohë të plotë Master i Arteve, Master i Shkencave dhe Master Profesional, të jenë 1.04.2020 deri më 15.04.2020.
2. Ti kërkojë Bordit të Administrimit të UART realizimin e pagesës së sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor, në lidhje me zhvillimin e praktikave mësimore të studentëve sipas përcaktimeve të germës f, pika 1, ndarja I e VKM-së nr. 77, datë 28.01.2015, për afatin e përcaktuar në pikën 1 të këtij Vendimi.
3. Dekanatet në UART të marrin masat e nevojshme për zëvendësimin e orëve mësimore të periudhës së praktikës mësimore, brenda semestrit të dytë.
4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Administratori i UART, Dekanët e Fakulteteve dhe Përgjegjësit e njësisë bazë të tre fakulteteve të UART.
5. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve dhe tek transparenca.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

